

VENDIM
Nr.65, datë 8.3.1990

PËR DISA PËRMIRËSIME NË KOMPETENCAT E ORGANEVE
SHTETËRORE DHE EKONOMIKE

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDOSI:

1. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.9.1982 “Për kreditin bankar”, neni 8 ndryshohet si vijon:

“Kur kooperativa bujqësore, për shkaqe të pajustificuara, nuk është në gjendje të kthejë kredinë në afatin e caktuar, me kërkesë të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, bëjnë zgjatjen e afatit për kthimin e kredisë”.

2. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 6.4.1985 “Për shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin dhe ruajtjen e makinerive e pajisjeve”, neni 3 ndryshohet si vijon:

“Ndalimi i punës së ndërmarrjeve, të makinerive e të pajisjeve në ndërmarrje, të reparteve e të makinave të veçanta, për rastet e riparimeve jashtë kohës së planifikuar dhe të uljes së aftësisë prodhuese, është në kompetencë të:

a) Ministrisë, institucionit tjetër qendror ose komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit për ndalimin e pjesshëm ose të plotë të punës së ndërmarrjeve.

b) Ndërmarrjes për makineritë e pajisjet, kur rrezikohet jeta e njerëzve ose mund të shkaktohen dëme të mëdha materiale, si dhe kur procesi i prodhimit, i ndërtimit ose i shërbimit nuk kryhen sipas teknologjisë së miratuar.

Për ndalesat e reparteve dhe të makinerive të rëndësishme, të parashikuara në shkronjën “b”, duhet të njoftohet menjëherë organi epror përkatës”.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.96, datë 21.7.1967 “Për tarifat për fëmijët që pranohen në çerdhe e kopshte”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Administrata e çerdheve dhe e kopshteve, në marrëveshje me prindërit, lejojnë që ekzekutimi i kuotës së ushqimit të bëhet me anë të pagës nga zyra e llogarisë së qendrës së punës së prindit”.

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.181, datë 10.6.1977 “Për rregulloren e Komitetit Shqiptar për marrëdhënie miqësore e kulturore me botën e jashtme”, neni 5 ndryshohet si vijon:

“Ministritë ose insitucionet e tjera qendrore dhe organizatat shoqërore që merren me çështje të marrëdhënieve kulturore e shkencore a me propagandën jashtë shtetit, për probleme që nuk përfshihen në planin e përgjithshëm kulturor, pasi konsultohen edhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme, miratojnë plane të veçanta për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit kulturor e shkencor me institucione e organizata paralele të vendeve të tjera”.

5. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.9, datë 27.2.1978 “Për miratimin e rregullores “Për regjistrimin dhe ndryshimet në gjendjen e tokave””, bëhen këto ndryshime:

- Neni 8 ndryshohet si vijon:

“Kur ndërtimi i veprave të ndryshme është i domosdoshëm dhe prej tyre dëmtohen masive ullaresh, pemësh e vreshtash, pavarësisht nga vlefata e objektit, projektideja i paraqitet për miratim Ministrisë së Bujqësisë, kur dëmtohen mbi 50 rrënjë ullaresh, mbi 300 rrënjë pemë ose mbi 10 ha vreshta”.

- Në nenin 14, shkronja “b” ndryshohet si vijon:

“Me miratimin e Ministrisë së Bujqësisë, kur toka e re hapet në kullotat, në livadhet, në shkurret dhe në pyjet e degraduara, pa perspektivë rimëkëmbjeje, që kanë në përdorim ekonomitë e rretheve të tjera”.

- Në nenin 14, shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“Me miratimin e Ministrisë së Bujqësisë, kur toka e re hapet në pyje industriale”.

6. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.57, datë 11.9.1978 “Për miratimin e rregullores “Për përgatitjen e ekspozitave dhe pavioneve në panairët ndërkombtëre””, bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i dytë i nenit 1 ndryshohet si vijon:

“Pjesëmarrja e vendit tonë panaiet ndërkombëtare bëhet me miratim të Ministrit të Tregtisë së Jashtme dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, sipas propozimit të ministrive ose të institucioneve të tjera qendrore të interesuara”.

- Neni 3 ndryshohet si vijon:

“Plani i pjesëmarrjes së vendit tonë në panaiet ndërkombëtare për vitin pasardhës miratohet në muajin prill të çdo viti nga Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Ministria e Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Dhomës së Tregtisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i ministrive e i institucioneve të tjera qendrore të interesuara”.

- Paragrafi i dytë i nenit 5 ndryshohet si vijon:

“Pas miratimit të pjesëmarrjes së vendit tonë në panaiet ndërkombëtare, Dhoma e Tregtisë hyn menjëherë në marrëdhënie me drejtoritë përkatëse të panaiereve ku vendi ynë do të marrë pjesë, por jo më vonë se në muajin shtator të çdo viti, që të sigurojë planimetritë përkatëse të pavionëve, si dhe të kryejë të gjitha formalitetet e tjera të nevojshme për ngritjen e tyre”.

7. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.176, datë 21.11.1979 “Për shpenzimet për pritje e përcjellje dhe trajtimin ekonomik që u bëhet delegacioneve dhe specialistëve të huaj”, në pikën 10 paragrafi 5 ndryshohet si vijon:

“Për dreka ose darka që shtrojnë ndërmarrjet e tregtisë së jashtme dhe ndërmarrjet e tjera ekonomike, sipas programit të miratuar nga drejtuesi i ndërmarrjes, si dhe për dreka ose darka e koktejlle që jepen në takimet e komisioneve lokale të kufirit dhe të grupeve të përbashkëta të specialistëve që punojnë për zgjidhjen e problemeve kufitare, të zbatohen kuotat e grupit të tretë të delegacioneve që përcaktohen në këtë pikë”.

8. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.465, datë 30.10.1980 “Për kalimin e shërbimeve të arkëtimit dhe për mënyrën e pagimit të qirasë së banesave, të përdorimit të energjisë elektrike e të ujit në ndërmarrjet komunale”, në pikën 1, pas paragrafit të tretë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Me dëshirën e qytetarëve, ndërmarrjet komunale lidhin marrëveshje me ata që shërbimi i arkëtimit të faturave për pagimin e qirasë së banesave, përdorimin e energjisë elektrike e të ujit, lyerjen e vendeve të përdorimit të përbashkët, shpërblimin e dëmit e të gjobës për dëmtimet e shkatërrimet, si dhe për pajtimet e bisedimet telefonike, të ekzekutohen drejtpërdrejt nga paga, nëpërmjet zyrave të llogarisë së qendrës së punës të qytetarit”.

9. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.348, datë 3.12.1982 “Për disa ndryshime në urdhëresa, në vendime dhe në udhëzime të Këshillit të Ministrave”, në pikën 24 shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve kanë të drejtë të caktojnë numrin e pjesëmarrësve dhe kuotën e ushqimit për dreka e darka, për festa lokale e kombëtare dhe përvjetorë jubilarë”.

10. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 22.10.1983, në nenin 3 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Gjithashtu ndalohet qarkullimi i veturave, mikrobusëve e i motoçikletave jashtë qytetit të shtunave e të dielave, me përjashtim të atyre që përfshihen në lidhjen nr.3 që i bashkëngjitet kësaj urdhërese. Në këto ditë, veturat, mikrobuzët dhe motoçikletat e aparateve të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore të ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave bujqësore dhe reparteve ushtarake, mund të qarkullojnë me autorizim të titullarit”.

11. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.19, datë 8.1.1983 “Për kompetencat e organeve shtetërore në fushën e miratimit të strukturave organizative, të numrit të punonjësve në organikë dhe të pagave”, në kreun B “Për pagat dhe shtesat në pagë”, pika 2/a ndryshohet si vijon:

- “Komisioni i Planit të Shtetit miraton shtesa në pagë për vështirësi pune, vendi dhe vjetërsi në punë, në analogji me ato që ka miratuar Këshilli i Ministrave, kur bëhet e nevojshme të zbatohen në ndërmarrje e në institucione të tjera.

- Ministria ose institucioni tjetër qendror miraton emërtime detyrash për efekt page, në analogji me ato të miratuara nga Këshilli i Ministrave, por që është e nevojshme të përdoren edhe në ndërmarrje e institucione të tjera.

- Ndryshimet në kategorizimet e ndërmarrjeve e të institucioneve për efekt page bëhen sipas vartësisë, përkatësisht nga ministria ose institucioni tjetër qendror sipas kritereve të caktuara nga Komisioni i Planit të Shtetit”.

12. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.145, datë 15.4.1983 “Për rritjen e frytshmërisë së

transportimit të mallrave me hekurudhë dhe për kursimin e karburantëve”, në pikën 1 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

-“Ndalimi i transportimit të mallrave dhe i lëvizjes së kamionëve në rrugë paralele me transportin hekurudhor dhe atë detar. Bëjnë përjashtim mallrat dhe kamionët që përcaktohen nga ministria ose institucioni tjetër qendror, në bashkëpunim me komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Ato përcaktojnë gjithashtu se cilat nga këto mallra do të transportohen me mjetet në ekonomi”.

13. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 8.2.1985 “Për kompetencat për miratimin e shpimeve në strukturat e reja gjeologjike dhe për kërkimin e naftës e të gazit”, pika 1 ndryshohet si vijon:

“Shpimet në strukturat e reja gjeologjike për naftë e gaz me projektthjellësi mbi 3000 m dhe shpimet me detyrë konturimi e vlerësim shfrytëzimi miratohen nga Ministria e Industrisë e Minierave dhe e Energjetikës, kurse shpimet me thellësi nën 3000 m miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe e Gazit”.

14. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.86, datë 21.3.1987 “Për disa përmirësime në kompetencat e organeve shtetërore dhe ekonomike”, në pikën 17 shkronja “c” shfuqizohet dhe shtohet pika 18 me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht nga kërkesat e caktuara për atestim për vjetësinë në punë dhe arsimin, ndërmarrja ka të drejtë të miratojë ngritjen e punëtorëve në shkallë kualifikimi me të lartë, kur puna e tyre ka efektivitet dhe ndikon në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor”.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI